



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.13, datë 25/07/2022

PËR

**MBI KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR. 6, DATË 30.09.2021
PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR RINOVIMIN E
KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”SHOQËRISË
“BARDHGJANA”SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 e 2, neni 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” 1.Organi publik,në cdo kohë,kryesisht apo me kërkesë,mund të korrigjojë gabimet e shkrimit,gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme,në një akt administrativ. 2.Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet,si dhe cdo kopje të njëhsuar të tij.

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e gabimit material në “leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor, subjekti “Bardhgjana”sh.p.k, në emërtimin e H/C nga H/C Bardhgjanë në H/C Bisak
2. Asnjë tregues tjetër nuk ndryshon përvec gabimit material **(Nga H/C “Bardhgjanë” në H/C “Bisak”**

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

